



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

SCC-09-0086

Paditësi

D F Graçanicë

kundër

Të paditurat

M “R dhe K “K – E” të cilat i përfaqëson **Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP)**, Rr. “Dritan Hoxha “nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Hajrie Shala gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 mars 2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit.**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 maj 2009, pranë DHPGJS, paditësi parashtron një padi pronësore.

Paditësi kërkoj që ti njihet e drejta e pronësisë, së ngastës kadastrale nr. 1617/1, në sipërfaqe prej 00.13.65 ha, në vendin e quajtur “L”, zona kadastrale L1 (prona kontestuese), si dhe të detyrohen të paditurat që pronën kontestuese të ja dorëzojnë në pronësi dhe posedim si dhe që kjo pronë të regjistrohet pranë librave kadastral në emër tij.

Paditësi përfaqësohej nga avokati Blerim Ejupi, nga Prishtina.

Paditësi pohoj se bazuar në Aktvendimin mbi arondimin, nr. 5557/64 datë 20 tetor 1964, i është marrë prona kontestuese (ngastra kadastrale 1617) dhe se si kompensim i është dhënë ngastra kadastrale nr. 1006, vendi i quajtur “O”.

Sipas paditësit edhe përkundër, Aktvendimit, të paditurat ende nuk ja kanë bartë të drejtën e pronësisë së ngastrës.

Paditësi përfundimisht pohon, se ai për 45 vitet e kaluara, e shfrytëzon dhe e ka në posedim ngastrën kadastrale nr. 1006.

Padisë i janë bashkangjitur:

- Kopje e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 1999/08 datë 24 prill 2009,
- Kopja e shkresës, drejtuar kryetarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, datë 28 tetor 2008,
- Kopja e Aktvendimit mbi arrondimin, nr. 557 /64 datë 20 tetor 1964, lëshuar nga Komuna e Prishtinës –Njësia për Ekonomi, Komisioni mbi arrondimin, me anë të cilit shihet se F T. T, në vend të ngastrës kadastrale nr. 1617/1, vendi i quajtur “L”, zona kadastrale L.S, në sipërfaqe prej 00.13.63 ha, i është dhënë ngastra kadastrale nr. 1006, vendi i quajtur “O”, zona kadastrale L.S, në sipërfaqe prej 00.15.53 ha, dhe
- Kopje e Padisë, e parashtruar pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë,.

Kërkesa e paditësit mbi lirimin nga pagesa e taksë gjyqësore, me Aktvendimin e DHPGJS datë 3 shtator 2009, aprovohet.

Me parashtrësën e parashtruar pranë DHPGJS me 16 shkurt 2010, përfaqësuesi i paditësit avokat Blerim Ejupi, njofton gjykatën se tërhiqet nga përfaqësimi i mëtutjeshëm i paditësit.

Bazuar në Aktvendimin e gjykatës, AKP me 3 dhjetor 2013 parashtrorj përgjigje.

AKP kundërshtoj padinë duke e konsideruar si të pabazuar në ligj. AKP kontestoj legjitimitetin aktiv të paditësit. AKP tutje kundërshton pretendimet e paditësit, gjithnjë duke u bazuar në dispozitat ligjore sipas Ligjit për procedurën kontestimore, Ligjit për AKP dhe Ligjit për procedurën jokontestimore. Nga të gjitha arsyet propozon që padia të refuzohet si e pabazuar.

Me urdhrin e gjykatës, përgjigja e AKP ju dorëzua paditësit me 9 dhjetor 2017.

Paditësi nuk parashtrorj përgjigje.

Me urdhëresën e gjykatës, palët u ftuan për seancën ndëgjimore të caktuar për datën 14 mars 2022, me fillim në ora 11.00.

Nga fletëkthesa për paditësin, D F, me të cilën është tentuar dorëzimi i ftesës për seancë me 23 shkurt 2022, nga ana e personit zyrtar është shënuar një shënim se: “*ka vdekur*”.

Seanca e caktuar për datë 14 mars 2022, nuk është mbajtur për shkak të mosplotësimit të kushteve teknike nga ana e personelit mbështetës të gjykatës.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).*

Neni 277 a) i LPK parasheh se Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale; Në bazë të nenit 280.1 të LPK, procedura gjyqësore e ndërprerë mbi bazat e parapara me nenin 277 paragrafi 1 pika a) deri d) e atij akti ligjor mund të vazhdohet

kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Në rrethana të tilla *prima facie* sipas nenit 277 dhe 280 të LPK-së, procedura gjyqësore duhet të ndërpritet derisa pasardhësit e palës së vdekur të paraqiten në gjykatë dhe të marrin përsipër çështjen gjyqësore në fjalë.

Është e panevojshme të thuhet se aktvendimi për ndërprerjen e procedurës gjyqësore nuk e përjashton mundësinë që trashëgimtarët e paditësit, D F, të ndërmarrin veprime juridike në lidhje me objektin e procedurës gjyqësore në fjalë, ngase një vendim i tillë nuk i përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe prodhon vetëm efekte procedurale.

Gjykata nuk i përjashton trashëgimtarët e paditësit që të marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Gjykata i udhëzon trashëgimtarët e paditësit që me rastin e propozimit të tyre mbi vazhdimin e procedurës të ja bashkangjesin edhe Aktvendimin mbi trashëgiminë për të ndjerin D F, që të dëshmojnë legjitimitetin e tyre aktiv.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet gjyqësore

Pasi që procedura është ndërprerë në këtë fazë të procedurës nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Hajrie Shala, Gjyqtar
